



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KRYETARI

Nr. 15380/ prot.

Vlorë, më 23.09 2025

Lënda: Kërkesë për mbledhje jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë.

Këshillit të Bashkisë Vlorë

Znj.Elpinqi Mërkuri

Kryetare

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar neni 53 pika 3 dhe pika 4, në Rregulloren "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë "Neni 60 pika 1/a, e në vijim, kërkojmë mbledhje jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë mundësisht brenda datës 30.09.2025. me rend dite:

1.Projektvendim “Për një rishpërndarje të fondeve në VKB nr.111 datë 27.12.2024 “Për Buxhetin e Bashkisë Vlorë 2025” i ndryshuar.

Po e paraqesim jashtë radhe këtë projektvendim, pas nevojave të Bashkisë për disa ndryshime në zërat e investimeve. Koha e kufizuar për prokurimin e tyre si dhe detyrimi në mbështetje të ligjit 9936 date 26.06.2008 për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, neni 51 në të cilin parashikohet se pas datës 15 tetor nuk mund të meren angazhime të reja buxhetore, në këto kushte e kemi të domosdoshme që të zhvillohet një mbledhje jashtë radhe e Këshillit të Bashkisë.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë ju dërgojmë projektvendimet si dhe relacionet përkatëse.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

KRYETAR

Elis Halili



CB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E FINANCËS, BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 15380 prot.Vlorë, më 23.09 2025

PROJEKTVENDIM
Nr. _____, Datë _____.2025

“PËR NJË RISHPËRNDARJE NË VKB NR.111, DT.27.12.2024
PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2025” i ndryshuar.

Në bazë të Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, pika 2, 9 pika 1.1 b, 34, 35, 36, 37,40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c , Ligji nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 45, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44 ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Menaxhimit të Buxhetit”, Udhëzimi plotësues nr.2 datë 28.02.2024 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2024”, V.K.B nr.111 datë 27.12.2024 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2025”. VKB nr 24 datë 27.03.2025 i ndryshuar.

VENDOSI:

1.Të miratojë vlerën financiare për realizimin e projektit si më poshtë :

A. Investime Artikulli 231	000/leke
1. Rikonstruksioni i shkollës Marigo Posjo	170.759
2. KUB Vlore(Kanalizimet e Ujrave te Bardha Vlore)	
Rindertimi ,Ridimesionimi dhe Reabilitimi i Kolektoreve	
Kryesore pergjate rruges Transballkanike,sipas loteve ,	
Rruga e Skeles deri te rruga Hasan Kushta(Albano dhe Romina),	
Odise Grillo si dhe Kolektori nga dalja e rruges Transballkanike	
deri ne shkarkimin ne Kanalin e Fushes.	279.441
SHUMA I	450.200

B .Shpenzime opertative Artikulli 602

1. Vendime Gjyqi

8.000

SHUMA II

8.000

TOTALI

458.200

2. Per Financimin e projekteve te pikes 1 do te perdoret shuma e mbetur nga paksimet e meposhteme ne zerin Investime.

1	Rikonstruksioni I Kopshtit 1 Maj	265,863
2	Mobilim shkolla Avni Rustemi	9,000
3	Rikonstruksioni I zyrave +magazinave te Q.Ekonomike	9,658
4	Ndertimi I ambjentit te serverit te tatimeve	8,400
5	Shpronesime	13,000
6	Rikonstruksion I trotuareve pergjate rruges Transballkanike	152,279
TOTALI		458,200

a) Pakësohen Investimet ne Programet (9120) (1110)(4520)

A Paksime

Kodi Prog.	Kapitulli	Kodi proj	Llog. ekonomike	Emertimi	Shuma
09120	5	1460432	231	Rikonstruksioni I Kopshtit 1 Maj	265,863
09120	5	1460443	231	Mobilim shkolla Avni Rustemi	9,000
01110	5	1460477	231	Rikonstruksioni I zyrave +magazinave te Q.Ekonomike	9,658
01110	5	1460350	231	Ndertimi I ambjentit te serverit te tatimeve	8,400
01110	5	1460349	231	Shpronesime	13,000
4520	5	1460434	231	Rikonstruksion I trotuareve pergjate rruges Transballkanike	152,279
Shuma					458,200

b) Shtohet Investimet dhe shpenzimet operative në programet (912) (1110)

Kodi Programit	Kapitulli	Kodi proj	Llog. ekonomike	Emertimi	Shuma
9120	5		231	Rikonstruksioni I shkolles Marigo Posjo	170,759
				KUB Vlore(Kanalizimet e Ujrave te Bardha Vlore)Rindertimi,Ridimesionimi dhe Reabilitimi i Kolektoreve Kryesore pergjate rruges Transballkanike,sipas loteve , Rruga e Skeles deri te rruga Hasan	
1110	5		231		279,441

				Kushta(Albano dhe Romina), Odise Grillo si dhe Kolektori nga dalja e rruges Transballkanike deri ne shkarkimin ne Kanalin e Fushes	
1110	5		602	Vendim Gjyqi nr 803 date 14.05.2025 Perllat Hallo ,Gramoz Alla	8,000
				SHUMA	458,200

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë .

4.Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në VKM nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

KRYETAR

ELIS HALILI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E FINANCËS, BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 15380 prot

Vlorë, 23.07.2025

RELACION

MBI NJË RISHPËRNDARJE TË FONDEVE NË VKB NR.111 DATË 27.12.2024 SI DHE VKB NR.24 DATË 27.03.2025” I NDRYSHUAR.

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të Nderuar Këshilltarë,

Projekvendimi mbi një Rishpërndarje të Fondeve në VKB Nr.111 datë 27.12.2024 “Për Buxhetin e Bashkisë për vitin 2025”i ndryshuar që po ju paraqesim për miratim lidhet me një rishpërndarje të fondeve të miratuara në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2025. Kjo rishpërndarje e fondeve vlerësohet e domosdoshme nga ana jonë pasi gjendja aktuale e shkollës “Marigo Posio” është shumë e degraduar dhe rikonstruksioni i saj ka qenë i miratuar me VKM nr.111 date 27.12.2024 si prioritet për investimet e Bashkisë.

Gjithashtu projekti, “Për Rikonstruksion i Trotuareve Përgjate Rrugës Transballkanike”, i miratuar në Buxhetin e vitit 2025 nga ana e stafit të Bashkisë duke parë dhe situatën e KUB në këtë rrugë është menduar të investohet për rehabilitimin e kolektorëve të ujërave të bardhë dhe në një fazë të dytë të vazhdohet me rikonstruksionin e trotuareve të këtij segmenti.

Ndërkohë në Bashkinë Vlorë është depozituar dhe vendimi i gjykatës Nr.12401(31146-012477-86-2019) date regj 02.04.2019., Regj.Them Nr.803(86-2025-1004) Vendimi date 14.05.2025

Për të cilin Administrata e Bashkisë Vlorë do të bëjë një pagesë të pjesëshme dhe diferencën do ta planifikoj në Buxhetin e vitit 2026, pasi zyra përmbarimore në bazë të vendimit të Gjykatës ka urdheruar Sekuestro Konsevative për llogaritë e Bashkisë Vlorë me Nr.888/1prot, datë 30.07.2025.

Kjo rishpërndarje e fondeve bazohet në ligjin e 9936/neni 44 dhe 48 26.06.2008 Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar si dhe në ligjin Nr.68/2017”Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”neni 45, “Rishpërndarja e Fondeve Buxhetore”.

Përsa është paraqitur në dokumentin bashkëlidhur, kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij projektvendimi.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Elis Halili


